

STATUTI

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "TIGER RENT CAR AND SALE"

Përkufizime

Në këtë statut termat :

- "Ligji" → është ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- "Statut" → është statuti "TIGER RENT CAR AND SALE" shpk
- "Ditë të plota" → në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit


1. Sot, më datë 05.10.2022 unë themeluesi kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin "TIGER RENT CAR AND SALE"
2. Themeluesit e shoqërisë janë :
 - ▶ Emër, Mbiemër : Eduard Marku
 - ▶ Emër, Mbiemër : Gianluca Barberis
 - ▶ Forma e shoqërisë : Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
 - ▶ Emri ligjor i shoqërisë : TIGER RENT CAR AND SALE
 - ▶ Adresa e shoqërisë : Rruga "Jordan Misja", Nd.46, H.17, Ap.4, Njësia Bashkiake nr.9.1016
Tiranë
 - ▶ Vendi rregjistrimit : TIRANË

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

- EKSPORT- IMPORT, tregtimi me shumicë dhe pakicë i te automjeteve dhe mallrave te ndryshme industrial etj.

EDUARD MARKU


GIANLUCA BARBERIS


- Dhenie me qera e automjeteve
- Import dhe dhenie me qera e mjeteve motorike ujore etj

Neni 3 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj : Për një periudhë kohore të pakufizuar.

Neni 4

Selia, Adresa e faqes së internetit dhe adresa elektronike

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Rruga "Jordan Misja", Nd.46, H.17, Ap.4,
Njësia Bashkiake Nr.9, 1016 Tiranë
1. Adresa elektronike : eduardpjetermarku@gmail.com
2. Numër celulari : 0698422222

KREU II

KAPITALI I RREGJISTRUAR

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit të rregjistruar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është : 100 lekë

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm :

- | | |
|---|--------------------------|
| ▶ Ortaku themelues : | <u>Eduard Marku</u> |
| ▶ Lloji i kontributit : | <u>LEKË</u> |
| ▶ Vlera e kontributit : | <u>50 lekë</u> |
| ▶ Numri i kuotave | <u>1 kuota</u> |
| ▶ Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë : | <u>50 %</u> |
| ▶ Ortaku themelues : | <u>Gianluca Barberis</u> |
| ▶ Lloji i kontributit : | <u>LEKË</u> |
| ▶ Vlera e kontributit : | <u>50 lekë</u> |
| ▶ Numri i kuotave | <u>1 kuota</u> |
| ▶ Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë : | <u>50 %</u> |

Vlera totale e kapitalit të rregjistruar është : 100 lekë

EDUARD MARKU


GIANLUCA BARBERIS


Vlera e paguar është :

100 lekë

2. Kapitali themeltar i shoqërisë është regjistruar :

QKB

Neni 6

Llojet e kuotave, të drejtave dhe kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e ortakëve të shoqërisë.

Neni 7


Kalimi i kuotave me trashëgimi ose si pasojë e falimentimit

1. Nëse Ortaku i shoqërisë vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët e tij do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij, pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e Ortakut të shoqërisë të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm.
2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruesi i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh një person tjetër të rregjistrohet si zotëruesi i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
3. Personi tjetër që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesmarrjes ose të votës, deri në momentin e rregjistrimit në QKB.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Shoqëria me vendim të ortakëve të shoqërisë mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet edhe me qëllim, pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.
2. Shoqëria me vendim të ortakëve të shoqërisë mund të zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë

EDUARD MARKU


GIANLUCA BARBEAIS


KREU III
ORGANET E SHOQËRISË

Neni 9

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakët e shoqërisë. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- ▶ miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ▶ shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- ▶ investime;
- ▶ vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.


Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 10

Emërimi i administratorit

"TIGER RENT CAR AND SALE" shpk ka si administrator të saj, ortakun **Eduard Marku** me numër ID **181116037R**.

Në pajtim me ligjin, neni 95, pëika 1, afati i emërimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje duke filluar nga data **05.10.2022** deri në datë **04.10.2027**.

Emër, mbiemër	Adresa	Specimenti i nënshkrimit
EDUARD MARKU	Rruga "Jordan Misja", Nd.46, H.17, Ap.4, Njësia Bashkiake Nr.9,1016 Tiranë	

Neni 11

Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

EDUARD MARKU


GIANLUCA BARBERIS


- ▶ kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- ▶ përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- ▶ kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ▶ përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me përdorimin e fitimeve;
- ▶ krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- ▶ kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT", ndryshuar me ligjin Nr.131/2015 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT";
- ▶ kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

KREU IV

DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 12

Dividentët

1. Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria mund të deklarojë shpërndarjen e dividentit.
2. Asnjë divident ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë, nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Neni 13

Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar

Administratori pas vendimit të marrë nga ortakët e shoqërisë dhe referuar përcaktimeve të nenit 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara, të cilët nuk do të përdoren për të paguar dividentë preferencialë, apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Neni 14

Viti financiar

EDUARD MARKU



GIANLUCA BARBERIS



Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiarë fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

KREU V PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 15

Prishja dhe shpërndarja

Prishja dhe shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar, siç mund të jenë :

- ▶ Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të veprimtarisë së saj.
- ▶ Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji Nr.8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin".
- ▶ Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Neni 16

Likujtimi

Në rast të likujdimit të shoqërisë, ortakët e shoqërisë marrin vendim me shkrim për emërimin e 1 ose disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likujdim e sipër".

Afati i emërimit të likujdatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës, duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Rregjistrimit të Shoqërive.

Likujduesi, në përputhje me ligjin dhe me vendimin e ortakëve të shoqërisë, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri.

Neni 17


Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18

EDUARD MARKU



GIANLUCA BARBERIS



Eduard
Marku

Digitally signed by
Eduard Marku
Date: 2022.10.15
21:35:20 +02'00'

Dispozita përfundimtare

Ky statut u përpilua në (tre) 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, të miratuar në parim dhe nen për nen dhe nënshkruar në të gjitha kopjet, duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën e tyre origjinale.

ORTAKËT

Eduard Marku

EDUARD MARKU



Gianluca Barberis

GIANLUCA BARBERIS

